REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 54/2019 (JR) **Tiranë, më 16.06.2021**
Nr. 54/4 regj.

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën **e martë, datë 13.07.2021, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, çështja me numër regjistri (JR) 54/2019, datë 28.10.2019, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli kundër vendimit nr. 177, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues	**Albana Shtylla**
Relatore e Çështjes	**Rezarta Schuetz**
Gjyqtar	**Ardian Hajdari**
Gjyqtare	**Ina Rama**
Gjyqtare	**Natasha Mulaj**

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT · GJYKATA KUSHTETUESE · SEKRETARIA · TIRANË